

Komuna e Mamushes
Data: 31.08.2020
Mledhja e 01 e Jashtëzakonshme e Asamblesë Komunale
Vendi: Mamushë

PROCESVERBAL

			
Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosovo-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuşa-Municipality of Mamushë			
Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing			
01	No.Nr.	12/A - 20	
Tarih/Dt.		31.08.2020	

Mledhja e 01 e Jashtëzakonshme e Asamblese Komunale është mbajtur me datë 30.08.2020 në ora 10:00 ne sallën e Asamblesë Komunale.

Mbledhja është udhehequr nga Kryesuesi i Kuvendit Z.Buyar Mazrek.
Në mledhje kanë marrë pjesë 14 anëtarë

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtar të Asamblesë, të nderuar misafirë mirë se erdhët në mbledhjen e 01 të jashtëzakonshme të Asamblese Komunale për vitin 2020. Mledhja është mbajtur në ora 10:00.

Rendi i dites:

1. Transferi i rezervave në shumën 50.677.00€ ;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtarë , për më tepër spjegime fjalën ia japim drejtorit për Buxhet dhe Financa Z. Turker Mazrek.

Turker Mazrek.

Përsëndetje për të gjithë, na i kemi pas disa rezerva të buxhetit të vitin të kaluar që i kemi votuar për këtë vit dhe ky buxhet ka qenë nëse hyn në fuqi ligji i ri i pagave por pasi që ligji i ri i pagave nuk ka hyrë në fuqi këto rezerva për mos me shkuar suficid ne po i transferojmë në projekte të ndryshme ekzistuese. Ne kemi menduar që këto mjete ti transferojmë në dy projekte, njëri projekt është për trafo elektrike 10.000€ por ministria nuk po lejon të transferohen në projekte të reja kurse projekti tjetër për Arsim, kurse pjesa e mbetur për projekte infrastrukturore. Për mos me shkuar suficid ne më mirë kemi vendosur që këto mjete ti transferojmë në projekte që kanë nevojë.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diqka me pyet, urdhëro Halim.

Halim Sadiku:

I nderuar Z. Kryesues, të nderuar anëtarë, drejtorë si dhe pjesëmarrës tjerë, qëtu e kemi domethënë mbikqyrja e kanalizimeve dhe rrugëve të hapura 31.437.00€. A kanë mjaftu ato tjera vetëm edhe këto 31.437.00€ për kanalizime të hapura , ku janë kanalizimet e hapura në Mamushë, në qoftëse din me na tregu se bajagi kto mbikqyrjet e kanalizimeve mu pom doket pare shumë e tepërt, domethënë për tri vjet i ki mbi 300 e kusur mi euro, kjo asht pak si e teprune se kemi ven ku me investu tjetër ka. Faleminderit.

Abdülhadi Krasniç:

Ju përsëndes të gjithëve, në pyetjen që e parashtror Halimi, nëse ju kujtohet ne në kuvend e kemi miratuar buxhetin që e kemi ndarë për blerjen e trafos dhe renovimin e shtyllave elektrike, këtë projekt e kemi dorëzuar në Ministri por Ministria nuk e ka pranuar. Këtë vit nëse do të kishte hyrë në fuqi ligji i ri i pagave atëherë në të gjitha institucionet do të përdorej buxheti rezervë por pasi që nuk ka hyrë në fuqi atëherë të gjitha komunave iu është dërguar shkresë që keto mjete rezervë mund ti përdorni në cilat projekte i shihni më të arsyeshme, ku ne si komunë e kemi përkrahur QMF-në 70-80,000€, rreth

10,000€ mund ta përkrahim Arsimin kurse mjetet tjera projekteve që ne duam por kur kemi pyt në Ministri për projektet që ne duam përgjigjen që kemi marrë ka qenë që për shkak që është vonë projekte të reja nuk mundeni me propozu por vetëm projektet egzistuese. Vijnë tek projekti i kanalizimit, jutë gjithë e dini që po vendosen kubëza të reja, po renovohen kubëzat e vjetra, kanalizimet e reja të mbyllyra por emri i projektit është kanalizim i hapur. Pra për krejt ndërhyrjet që ka në Mamushë për kanalizime i kemi përshtirë në një tender. Pra kjo është qështja, ne edhe nëse propozojmë projekte të reja për arsye që është vonë ne po vazhdojmë me projekte ekzistuese.

Halim Sadiku:

A ban shqip me ma spjegju qeto?

Abdülhadi Krasniç:

Na i kemi dërgu në ministri projekt propozimet por për shkak se është vonë mundemi me vazhdu vetëm me projekte ekzistuese. Për shkak që qdo ditë po ndërtohen shtëpia, kubëzat kanalizimet janë prishur, në disa vende kanë fjet kubëzat dhe për këtë arsye po detyrohemi me bërë ndërhyrje, disa janë ndryshu, disa janë riparuar. Në vend që me qel qdo ditë ku ka nevojë tender, në jëmi mundu me i përfshi të gjitha shërbimet me një tender sepse kjo edhe po merr kohë. Na i kemi paraprëedhe disa riparime të kanaleve, rrugëve. Ky është projekti pak ma gjerësisht. Na menum me qit naj projekt të ri por pasi që ministria nuk na lejoj me projekt të ri na vazhdum te qeky ekzistuesi. Arsimin kemi patjetër me ndihmu se për shkak të pandemisë sivjet si kemi ndihmu Arsimin, shëndetësisë i kemi ndihmu kogja mirë edhe për qato pe kqyrim mundësinë pe qesim në arsim, nëse do të ja nis msimi normal na do të mundohemi ligjërisht me i siguru kushtet për me viju mësimet ne kushte normale. Trafon mujin e kalum me mbështetjen e shumicës së asambleistave kemi votuar mjete por u kon problemi që ministria sna pranoj, aiprojekt ka qenë me planifikim prej të hyrave edhe mos me kalu aaj su kon problemi sepse aato mjete mbesin edhe mundemi edhe vitin tjetër me i shfrytëzu. Faleminderit shumë.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Faleminderit Kryetar, urdhëro Halim.

Halim Sadiku:

Kjo është mendimi edhe propozimi jem, qka është planifiku buxheti me rritje të pagav 50,677,00€. Na e dimë në qfarë rrethana jemi tu jetu si pasojë e pandemisë, domethënë sektori i bujqësisë niher përneher është një ndër prej sektorëve më te ndishëm, unë propozimi jem, mendimi jem është që qeto mjete edhe mjetet shtesë bile, sepse na këtë vit nuk mundemi me i përfundu të gjitha rrugët, kubëzat, pse na nuk qohemi përshembull edhe me jetu jetën me qeta qytetarë, me qeta bujq edhe mu qu mi bo edhe ni shtesë tjetër, pra mi bo 70,000 ose 80,000€ edhe mu qu me ja zbut borgjet bujqëve, me gjet ni formulë që komuna mi ndihmu bujqëve që pranverae vitit të ardhshëm mos mi gjet të lodhën sepse pasojat e ksaj kan me nis vitin e ardhshëm. Ky është propozimi jem po nëse pajtohet shumica me gjet formë se ka rrugë edhe mi dhon prioritet bujqësisë, mos të na bjen neve aj epiteti që e kemi marrë jo vetëm ne Kosovë por edhe në krejt rajonin jemi njohur si bujq më punëtor. Mbikqyrje të kanalizimeve, meniher e kisha bo X si dhe të gjitha projektet që janë me më pak prioritet i kisha anuluar menjëherë edhe iu kisha drejtu direkt bujqëve të Mamushës, hajdeni ktu, qka mujna me bo për juve.Faleminderit shumë.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Faleminderit Halim, urdhëro Kryetar.

Abdülhadi Krasniç:

Halim ne jemi munduar në maksimum me e përkrah bujqësinë dhe bujqit e Mamushës. Buxheti prej 30.000€ për me i përkrah bujqit është pak edhe nuk kemi as mundësi me gjetë ndonjë donacion nga jashtë. Të hyrat vetanake ne muajin Prill kanë qenë 16 € për shkak se ka qenë pandemia, janë shtyrë disa pagesa. Në takimin që e kemi zhvilluar të Ejten me Ministrin ka mbetur që mbrenda kësaj jave të bëhet

shpërndarja e mjeteve, sepse kur ka marrë vendim qeveria ka vendos që të dorëzohen dokumentet e 22 komunave dhe mandej përmes një kanali të lëshohen mjetet për të gjithë. të gjithë e dijmë që bujqit kanë me u përkrah me një shumë prej 551,000€. 400,000€ e para kur janë shpërndarë janë shpërndarë me një metodë ndryshe, mjetet janë lëshuar në llogari të komunës mandej komuna i ka shpërndarë por këtë herë është ndryshe, Qeveria ka marrë vendimin, mjetet ia ka lëshuar ministrisë së bujqësisë ndërsa komunat i kanë kërkuar dërgimin e raporteve. Ne i kemi dërguar një raport ata na kanë kthyer edhe na kanë kërkuar edhe një raport tjetër. Shembull Qamil Mazrek ka mi marrë 1,000€, mbrenda kësaj sa janë për najllon, sa ari spinaq, lakër apo qka ka tjetër dhe ata kanë vendos sa është vlera e gjithë këtyre kulturave bujqësore. Ne do të mundohemi me i përkrah bujqit me 30,000€ por kjo nuk mjafton sepse unë si kryetar i komunës mendoj që me këtë shumë bujqëve mundemi vetëm me ia nda nga një thes me pleh artificial ashgjë më tepër sepse ne kemi shumë bujq. Nëse na përkrah qeveria mundemi me i ndihmu. Qdo ditë po kemi ankesa nga qytetarët për kubëza, kanalizime, rrymë. Trafot nuk janë në rregull. Po i kthehemi edhe një herë bujqëve, me përkrahjen e juaj dhe me mundimet tona sma merr menja që deri më tani është bërë ndonjë përkrahje më e madhe për bujqit, nëse kemi mundësi do ti kishim përkrahur edhe më tepër sepse e dijmë që 90% e popullsisë së Mamushës po mirren me bujqësi. Me 30,000€ po kam frikë që do ju shkaktojmë më shumë dëme sesa dobi sepse po ka shumë problem në shpërndarje. Unë kisha thënë që këtë herë këte rezerve ta transferojmë ku thamë më herët ndërsa buxheti tjetër kur të vjen të ndajmë për bujq më tepër. Na kanë dërguar edhe shkresë nga ministria që këtë vit janë mnagut 18 nxënës dhe kemi 200,000€ mangut dhe ne jemi duke u munduar që nëpërmjet deputetëve që janë kuvendin e Kosovës që nëse mvaren prej votave tona ti kushëzojmë që buxhetin mos ta zvogëlojnë. Shpresa jonë është që me marrë përkrahje nga Ministria 150-200,000€, nëse e marrim këtë përkrahje të tërën do ta ndajmë në subveencione për bujq. Neve na kanë dhënë fjalën që mbrenda kësaj jave kanë me u lëshu mjetet për bujqit, a i lëshojnë apo jo është vendimi i tyre. Nëse do të mund ti marrim 150-200,000€ buxhet për bujqësi atëherë ulemi prapë dhe bisedojmë dhe diskutojmë për ku dhe si me i shpërnda. Faleminderit.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Faleminderit Kryetar urdhëro Fuat.

Fuat TAÇ:

Ju nuk keni vend ku me i hargju këto mjete

Abdülhadi Krasniç:

Ne i kemi projektet e gatshme në vlerë prej 6-700.000€.

Çamil MAZREK:

Shtyllat elektrike në lagjen tonë janë shumë rrezik, a do të ndërrohen a jo?

Halim Sadiku:

Kushqo që jemi tu jetu këtu kemi qef me pa mirë, sepse kjo na prek të gjithëve, ska treg, kudo që shkon nuk shitet malli edhe me ja fal se merr. Qatë asht problemi se qysh me ia dal, duhet mu u l me bisedu, mi nal darkat, drekat, naftat lluksin mi nal krejt qka asht edhe me shku ne favor të bujqut. Mbikqyrja e kanalizimeve, unë për momentin mbikqyrjen e kanalizimeve e kisha nal, e kisha stopu me automatizëm me urgjence, qdo sen kisha ndërpre, gjitha aktivitetet tjera i kisha ndërpre, se qka mujna me bo për bujqit, mu ballafaqu me protesta, me gjithqka. Sepse nëse na si Mamushë bimë me prodhimin e domateve dhe me prodhimin e gjanave tjera që janë në bujqësi na sun ngritemi mo, na smujna me ndjek tregun. Kështu që na do ta miratojmë sepse e dimë që na nuk mujna me bo planifikim për kto mjete sepse planifikimi veq ka marrë fund, është fakt që duhet mi fut me naj projekt tjetër por te hargjimet viti 2020-2021 duhet me pas kujdes të madhë. Faleminderit.

Abdülhadi Krasniç:

Halim ne nga drekat darkat na i kemi reduktu shumë mjete dhe kemi vendosur bujqit ti përkrahim sado pak me traktorë, frezë, motokultivatorë. Vitin e kaluar kemi dal ne tender dhe prej mallrave dhe shërbimeve kemi paguar 9.000€ për hartimin e projekteve dhe nga ky projekt Mamusha ka përfituar 1.100.000-1.150.000 euro projekte. Është bërë një planifikim për furnizim me sera për 35-40 persona, kanë aplikuar më shumë se 60 persona. Siq e thashë edhe më herët përkrahja më e madhe indirekte këtë vit Mamusha këtë vit ka me përfitu mbi 2.000.000€ sera, para disa viteve qeveria na ka përkrahur me 400.000€. Mamusha ka me pas akoma probleme me dëmet nga dukuritë atmosferike sepse lumenjtë po mbyllen, po dalin nga shtrati. Përveq kësaj këtë javë ndoshta jo por javën e ardhshme do të mundohemi ti shpërndajë pajisjet që janë blerë për festival të domateve. Nepo mundohemi që ta rrisim buxhetin e komunës sepse me të vërtetë vitin e ardhshëm nuk kemi me mundur me realizu projekte. Kjo është sa i përket buxhetit.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diqka tjetër me shtu nëse jo atëherë unë do e marrë fjalën. Së pari e falenderoj Republikën e Turqisë gjithashtu edhe juve Z. Kryetar që keni arritur ta sillini autoambulancën. Halimi duhet të paktën me falendëru Republikën e Turqisë. A ka dikush diqka me shtu, nëse jo atëherë votojme

-Po 14
-Jo 0
-abstenim 0

Me vota unanime transferi u pranua.

Të nderuar anëtarë nëse nuk keni diqka me shtu në të ndryshmet atëherë mledhja ka përfunduar. Faleminderit për pjesëmarrje.

Proces mbajtësi
Idriz Mazrek

Kryesuesi i Kuvendit
Buyar Mazrek

